



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Gjykata Kushtetuese / Ustavni sud / Constitutional Court

Perandori Justinian p.n., Prishtinë/a, Kosovë/o
Tel: +381 (0)38 220 104/5; Fax: +381 (0)38 220 112; www.gjk-ks.org

SEKRETARIA / SEKRETARIJAT / SECRETARIAT

Datë: 16 tetor 2009
Akti Nr. SP 100/09/ash

Komunikatë për shtyp

Gjykata Kushtetuese e Kosovës, me 16 tetor 2009, me shumicë votash ka marrë vendim për caktimin e Masës së Përkohshme ndaj zbatimit të nenit 20.1 të Ligjit mbi Radio Televizionin e Kosovës deri në vendosjen meritorë të rastit **KI. 11/09**, *Tomë Krasniqi kundër Radio Televizionit të Kosovës dhe të tjerët*.

Vendimi për caktimin e Masës së Përkohshme është marrë pas Seancës Dëgjimore, të mbajtur me 6 tetor 2009, dhe mbledhjes për shqyrtim të gjyqtarëve, të mbajtur me 12 dhe 13 tetor 2009.

Sipas këtij vendimi, i rekomandohet Kuvendit të Republikës së Kosovës që ta rishikojë nenin 20.1 të Ligjit mbi Radio Televizionin e Kosovës dhe praktikën e bazuar në të, jo më larg se 1 dhjetor 2009. Njëkohësisht Gjykata Kushtetuese ka përcaktuar se vendimi meritor për këtë rast do të merret pas datës 1 dhjetor 2009.

Vendimi për caktimin e Masës së Përkohshme bazohet në nenin 116 të Kushtetutës së Kosovës, nenin 27 të Ligjit mbi Gjykatën Kushtetuese të Kosovës dhe neneve 52 dhe 59 të Rregullores së Punës së Gjykatës Kushtetuese.

Vendimi është publikuar në faqen ueb të Gjykatës Kushtetuese www.gjk-ks.org.